

VENDIM
Nr. 71, datë 3.2.2017

**PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION I SHËTITORES ‘ALI PASHA’, RESTAURIM I FASADAVE, NDRIÇIM,
SISTEMIM TROTUARESH”, BASHKIA TEPELENË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i shëtitores ‘Ali Pasha’, restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”, Bashkia Tepelenë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tepelenë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “ndërtesë”, me sipërfaqe 227.9 (dyqind e njëzet e shtatë pikë nëntë) m², me vlerë të përgjithshme prej 2 013 023 (dy milionë e trembëdhjetë mijë e njëzet e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 013 023 (dy milionë e trembëdhjetë mijë e njëzet e tre) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Tepelenë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Tepelenë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Tepelenë të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 227.9 (dyqind e njëzet e shtatë pikë nëntë) m², “ndërtesë”, për realizimin e projektit “Rikonstruksion i shëtitores ‘Ali Pasha’, restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh” të bëhet në favor të Bashkisë Tepelenë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme,
Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë dhe Bashkia Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË
 “RIKONSTRUKSIONIT TË SHËTTTORES ‘ALI PASHA’, RESTAURIM I FASADAVE, NDRIÇIM, SISTEMIM
 TROTUARESH”, NË BASHKINË E TEPELENËS

Nr.	Emri mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja m ² , ndërtim	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Kastriot Hysa	10/76-Nj	3574	51.1	941335	Konfirmim nga ZRPPP-ja
2	Erald Alika	10/76-Nj	3574	51.7	847360	Konfirmim nga ZRPPP-ja
3	Fatmir Seiti	10/76+1-1	3574	125.1	224328	Konfirmim nga ZRPPP-ja
	TOTALI				2 013 023	